



Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës
Komora Fizioterapeuta Kosova
Kosovo Chamber of Physiotherapists

NR.I PROTOKOLIT 612

NR I FAQEVE TË BASHKANGJITURA 07

DATA 22.12.2023 PK 26

PRISHTINË - KOSOVË

Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova
Kosovo Chamber of Physiotherapists

RREGULLORE

E PUNËS SË KUVENDIT TË ODËS TË FIZIOTERAPEUTËVË TË KOSOVËS



Prishtinë, Dhjetor 2023

Adresa: Kompleksi i Q.K.U.K, Klinika e Mjeksisë Fizikale me Rehabilitim, Kati i I-rë, RKS-10000.
Address: UCCK Complex, Physical Medicine Clinic with Rehabilitation, 1st Floor, RKS-10000.
Tel +383(0) 45 460 551; e-mail info@oftk-ks.org; web : www.oftk-ks.org

Oda e
Fizioterapeutëve
të Kosovës





Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

Kosovo Chamber of Physiotherapists

KUVENDI I ODËS SË FIZIOTERAPEUTËVE TË KOSOVËS në bazë të nenit 47 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor nr 04/L-150, nenit 20.1, 20.4 dhe Nenit 22 të Statutit të Odës të Fizioterapeutëve të Kosovës, Kuvendi i Odës të Fizioterapeutëve të Kosovës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 22.12.2023 miratoi :

RREGULLORE

E PUNËS SË KUVENDIT TË ODËS TË FIZIOTERAPEUTËVË TË KOSOVËS

(Tekst i spastruar me plotësime ndryshime sipas Vendimit nr.604, dt.22.12.2023)

Neni 1

I. Dispozitat e Përgjithshme

1. Me këtë rregullore mbi punën e Kuvendit të Odës të Fizioterapeutëve të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: rregullore) përcaktohet: mënyra e konvokimit dhe ftesës, konstituimi dhe betimi i anëtarëve të kuvendit zgjedhor të mbledhjes së kuvendit i Odës të Fizioterapeutëve të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm, Kuvendit), kuorumi për mbledhje dhe vendosje, kryesimi i mbledhjes së kuvendit, zhvillimi i mbledhjes së kuvendit, mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të kuvendit, të drejtat dhe obligimet e anëtarëve të kuvendit, procesverbalet, dispozitat kalimtare dhe qështje të tjera të rëndësishme për punën e kuvendit.

Neni 2

II. Mbledhja Konstituive

1. Mbledhjen e parë konstituive e fton kryesuesi i Komisionit Qendror Zgjedhor për përgaditjen, konstituimin dhe fillimin e punës së Kuvendit të OFTK-së.
2. Kryesimin e mbledhjes së Kuvendit, gjerë në zgjedhjen e Kryetarit të odës e bënë anëtari me i vjetër i kuvendit dhe në raste të mungesës së tij e bënë anëtari më i vjetër prezent në mbledhjen konstituive të kuvendit.
3. Mbledhja konstituive e kuvendit duhet të mbahet më së largu 30 ditë nga dita e certifikimit të rezultateve nga Komisioni Qendror Zgjedhor për anëtarë të Odës të Fizioterapeutëve të Kosovës.
4. Kryesuesi i mbledhjes konstituive të Kuvendit të OFTK-se nuk ka të drejte të ndërpres mbledhjen konstituive sepse është anëtar i barabartë me anëtarët e tjerë të zgjedhur nga vota e profesionistëve shëndetësor - votimet, deri në zgjedhjen e kryetarit të kuvendit të OFTK-së. Vetëm në raste të votimit të anëtarëve pjesëmarrës në mbledhjen konstituive të Kuvendit të OFTK-së edhe atë 50 % plus 1 votë dhe duhet të ketë kuorum të mjaftueshëm, i cili kuorum duhet të numërohet para ç'do votimi.

Neni 3

1. Pas verifikimit të mandateve, anëtarët e odës betohen solemnisht. Teksti i deklaratës është:

" Unë, anëtarë i Kuvendit të Odës së Fizioterapeutëve të Kosovës, betohem se me nder e me përkushtim do ta kryej detyrën time dhe do t'i përfaqësoj me dinjitet interesat profesionale të anëtarëve të odës, promovojë dhe mbrojnë





Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

Kosovo Chamber of Physiotherapists

*veprimtarinë profesionale shëndetësore dhe do të kontribuoj në përmirësimin e cilësisë së kujdesit shëndetësor”
Beto hem!*

Neni 4

1. Komisioni Qendror Zgjedhor në mbledhjen e parë konstituive njofton kuvendin mbi ecurinë e zgjedhjeve dhe rezultatet zgjedhore sipas njësive zgjedhore.

Neni 5

III. Kuorumi dhe votimi në mbledhjet e Kuvendit

1. Kuvendi ka kuorum kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të Kuvendit.
2. Vendimet e mbledhjeve të kuvendit janë të vlefshme, në qoftë se në kohën kur ato janë marrë në sallë kanë qenë më shumë se gjysma e anëtarëve të kuvendit
3. Vendimet dhe aktet e tiera të kuvendit konsiderohen të miratuara nëse për to votojnë shumica e anëtarëve të pranishëm. Përgjithshëm bëjnë rastet kur me Statut të Odës parashihet ndryshe.
4. Miratimi, ndryshimi dhe plotësimi i Statutit të Odës bëhet me votimin e 2/3 të votave të anëtarëve nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të odës.
5. Votimi bëhet në njërin nga këto mënyra:
 - a) votimi i hapur, me ngritje të dorës: "për", "kundër" dhe "abstenim"
 - b) votimi i fshehtë ose
 - c) votimin duke e thirrur secilin anëtarë, veç e veç.
6. Kuvendi vendos se cila nga këto mënyra të procedohet për votim.
7. Votimi i fshehtë bëhet në listat votuese të ndihmuar nga komisioni i formuar nga Kryetari i odes për këtë rast.

Neni 6

IV. Mbledhjet e Kuvendit

1. Mbledhjet e kuvendit mbahen sipas nevojës si paku një herë në vit.
2. Mbledhjen e kuvendit e fton kryetari i OFTK-së.
3. Kërkesën për mbledhje të jashtëzakonshme të kuvendit mund t'ia parashitë Këshilli i Drejtues se paku 1/3 e anëtarëve të kuvendit nga numri i përgjithshëm.
4. Ftesa së bashku me rendin e ditës për mbledhje i dërgohet anëtarëve të Odës së paku 7 ditë para mbajtjes së mbledhjes
5. Për mbledhjet e jashtëzakonshme (ftesa me rendin e ditës i dërgohet anëtarëve të odes së paku 3 ditë para mbajtjes së mbledhjes).





Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova
Kosovo Chamber of Physiotherapists

Neni 7

V. Kryesimi i mbledhjeve

1. Mbledhjet e kuvendit i kryeson dhe i udhëheqë Kryetari i odes e në mungesë të tij zëvendësi.
2. Kryetari i odës ka për detyrë:
 - a) Të ftojë mbledhjen
 - b) Të caktoj rendin e ditës
 - c) Të mbajë rendin në mbledhje
 - d) Të përcaktojë radhën e shqyrtimeve dhe votimeve
 - e) Të zbatojë dhe të i interpretojë rregulloren e punës së kuvendit
3. Marrja e fjalës në mbledhjen e kuvendit mundësohet pasi është miratuar nga Kryetari i OFTK-së
4. Kryetari i Odës i lejon diskutimet dhe i jep fjalën anëtarëve të odës sipas radhës së paraqitjes.
5. Diskutuesit mund të tërhiqet vërejtja që ti përmbahet rendit të ditës. Nëse folësi edhe pas tërheqjes së vërejtjes nga kryesuesi i kuvendit edhe më tej nuk i përmbahet rendit të ditës, atëherë i ndërpritet diskutimi.
6. Kryetari i Odës kujdeset që anëtari që e ka fjalën të mos pengohet nga anëtarët e tjerë.
7. Anëtari i kuvendit të odës që dëshiron të diskutoj për shkelje të rendit të ditës dhe rregullores së punës, kryetari i odës ka për obligim t'ju mundësoje menjëherë diskutimin
8. Kryetari i odës duhet të jap sqarim për pretendimet e shkeljes të rendit të ditës dhe rregullores së punës së kuvendit.

Neni 8

1. Kryetari i odës vendos që anëtari i odës për çështjen e njëjte diskuton vetëm njëherë, si dhe mund të kufizojë kohëzgjatjen e diskutimit.
2. Në rast replike diskutimi mund të zgjasë deri në dy minuta.

Neni 9

VI. Te drejtat dhe detyrimet e anëtarëve të kuvendit të odës

1. Anëtari i kuvendit të odës ka këto të drejta dhe detyrime:
 - a) Të marrë pjesë në mbledhjet e kuvendit,
 - b) Të paraqes propozime dhe pyetje
 - c) Të marrë pjesë në mbledhjet e organeve të odës në të cilat është anëtar dhe të votojë
 - d) Të marrë pjesë në mbledhjet e organeve të odës ku nuk është anëtarë pa të drejtë vote.
2. Me kërkesën e anëtarit të odës, ati i prezantohen dhe i dërgohen të gjitha materialet, aktet të nxjerra nga kuvendi, organet e kuvendit dhe informatat për punën e shërbimit profesional të odës.





Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

Kosovo Chamber of Physiotherapists

3. Anëtari i Kuvendit i cili mungon dy e më shumë herë radhazi pa arsye në mbledhje e thirrura nga Kuvendi, anëtari në fjalë përjashtohet nga anëtarësia si anëtar në kuvend të odës.
4. Anëtari i kuvendit të odës mund të kërkojë nga kryetari i odës, kryetarët e organeve të odës sqarime plotësuese për çështjet që janë në rend të ditës të kuvendit të odës.
5. Anëtari i odës ka për obligim të respektoj aktet e odës, të ruajë dhe të kultivoj etiken profesionale dhe kolegjalitetin.
6. Anëtari i odës ka për obligim të ruaj informatat e besueshme mbi punën dhe veprimtarinë e odës.
7. Anëtari i kuvendit të odës mund t'i paraqes pyetje kryetarit të odës, organeve të odës nga fushëveprimi i punës së odës për çështje që kanë të bëjnë me zbatimin e statutit dhe akteve tjera normative si dhe mbi punën e odës në përgjithësi.
8. Pyetja mund të parashtrohet gojarisht ose me shkrim në mbledhjen e kuvendit, kryetarit të odës për periudhën në mes dy mbledhjeve të kuvendit.
9. Nëse përgjigjja nuk i jepet anëtarit në mbledhjen e njëjtë të kuvendit kryetari i odës ka për obligim që parashtruesit të pyetjes t'i jap përgjigje me shkrim më së largu 15 ditë nga dita e parashtrimit të pyetjes.

Neni 10

VII. Mbarëvajtja mbledhjes

1. Kryesuesi i kuvendit të odës ka për detyrë mbarëvajtjen në mbledhjen e kuvendit.
2. Kryesuesi i mbledhjes në raste të prishjes së rendit dhe qetësisë gjatë seancës së odës mund të shqiptoj këto masa:
 - a) Vërejtje me gojë
 - b) Ndërprerja e diskutimit
 - c) Largimi nga mbledhja.

Neni 11

1. Vërejtja i shqiptohet anëtarit të odës i cili me sjelljet ose fjalimin e tij pengon rrjedhën e rregullt të mbledhjes dhe shkel dispozitat o kësaj rregulloreje e sidomos nëse nuk i përmbahet rendit të ditës, ndërhyrjen në diskutim të anëtarëve të odës dhe diskuton pa marrë fjalën paraprakisht nga kryetari i odës.

Neni 12

1. Anëtarit të kuvendit të odës i ndërprehet diskutimi në rastin kur sjellja e tij pengon mbarëvajtjen e rregullt të punës së kuvendit duke fyer kryetarin e odës dhe anëtarët e kuvendit edhe pas tërheqjes së vërejtjes nga ana e kryetarit të odës.





Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

Kosovo Chamber of Physiotherapists

Neni 13

1. Largimi nga mbledhja i shqiptohet anëtarit të kuvendit në rast të mosrespektimit të rregullores së punës dhe duke bërë sjellje jo dinjitoze me ç'rast vihet në pikëpyetje vazhdimi i rregullt i punës së kuvendit.

Neni 14

VIII. Rrjedhja e mbledhjes

1. Mbledhjen e hap dhe udhëheq kryetari i odës, i cili i jep informacionet e duhura mbi punën e kuvendit, konstaton kuorumin dhe njofton anëtarët e Kuvendit për numrin e anëtarëve prezent.
2. Pas miratimit të rendit të ditës kalohet në shqyrtim për çështjet që janë paraparë në rend të ditës.
3. Kryetari i odës e mbyll diskutimin kur konstaton se nuk ka anëtarë të tjerë të paraqitur për diskutim ose përfundojnë çështjet e parapara me rendin e ditës.

Neni 15

1. Kuvendi i odës merr vendime me shumicën e votave të anëtarëve prezent në mbledhje përveç në rastet kur me Statut është paraparë ndryshe.

Neni 16

1. Votimi në Kuvend bëhet sipas nenit 5 të kësaj rregullore.

Neni 17

IX. Interpretimi autentikë

1. Kuvendi i odës gjegjësisht komisioni statutar bënë interpretimin autentikë të Statutit, akteve tjera të përgjithshme dhe vendimeve të nxjerra nga kuvendi.
2. Kërkesën për interpretim autentikë mund ta paraqes anëtari i odës, anëtari i kuvendit të odës, organet e odës, shoqatat e ndryshme profesionale dhe institucionet e tjera përgjegjëse për zbatimin e akteve të odës.
3. Kërkesa për interpretim autentikë i behet kryetarit të odës dhe duhet te përmbajë saktësisht dispozitën ose aktin konkret për të cilin kërkohet interpretim.

Neni 18

X. Procesverbale

1. Për punën dhe rrjedhën e kuvendit mbahet procesverbal.
2. Procesverbali përmban të dhënat kryesore mbi rrjedhën e mbledhjes, mbi rendin e ditës mbi shqyrtimet dhe diskutimet si dhe për votimet dhe vendimet e miratuara.
3. Procesverbali domosdoshmërisht përmban edhe rezultatet e votimit për çështje te caktuara.
4. Procesverbalet arkivohen dhe ruhen si dokumentacion zyrtar.

Adresa: Kompleksi i Q.K.U.K, Klinika e Mjeksisë Fizikale me Rehabilitim, Kati i I-rë, RKS-10000.

Address: UCCK Complex, Physical Medicine Clinic with Rehabilitation, 1st Floor, RKS-10000.

Tel +383(0) 45 460 551; e-mail info@oftk-ks.org; web : www.oftk-ks.org

Oda e
Fizioterapeutëve
të Kosovës





Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova
Kosovo Chamber of Physiotherapists

Neni 19

1. Procesverbali nga mbledhja paraprake, në fillim të çdo mbledhje miratohet nga anëtarët e kuvendit të odës me vërejtjet apo sugjerimet eventuale.
2. Kuvendi vendos për arsyeshmërinë e vërejtjeve të paraqitura, dhe në rast të miratimit të tyre bëhet ndryshime dhe plotësime të procesverbalit.
3. Procesverbali i miratuar nga kuvendi nënshkruhet nga kryetari i odës dhe procesmbajtësi
4. Mbledhjet e kuvendit mund të regjistrohen në formë elektronike.

Neni 20

XI. Dispozitat kalimtare

1. Për zbatimin e kësaj rregullore obligohen Kryetari dhe anëtarët e Odës.
2. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregullore bëhen sipas procedurës që ka paraprirë nxjerrjes.

Neni 21

1. Me miratimin e kësaj rregullore shfuqizohet rregullorja paraprake e punë së Kuvendit të OFTK-së.
2. Kjo Rregullore hyn në fuqi nga muaji Janar i vitit 2024.

Prishtinë, 22.12.2023

Kryetar i OFTK-së
Ass.MSc.Feim Gashi PT

